



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:258903

Datë: 11.11.2024

Numri i dokumentit: 06435574

C.nr.260/19

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania e Sigurimeve "P." SH.A me seli në rrugën "E. L." Objekti 2, Lagjja Arbëria, Prishtinë e përfaqësuar nga përfaqësuesi i autorizuar S. R., kundër të paditurit M. (Z.) S. me vendbanim në rrugën "H. Z.", fshati K. e R., Prishtinë, për pengim posedimi jashtë seance me datë 31.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia e paditësit Kompania e Sigurimeve "P." SH.A, Prishtinë, kundër të paditurit M. S. nga Prishtina për rimbursim të dëmit, lënda me shenjën C.nr 260/19.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania e Sigurimeve "P." SH.A, Prishtinë ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit M. S. në Prishtinë.

Gjykata me datën 25.01.2024 ka marr aktvendimin për përgjigje në padi të cilin ja ka dërguar paditësit në adresën e dhënë si në padi, e cila adresë ka rezultuar të jetë jo e plotë. Pas kësaj, gjykata aktvendimin për plotësimin e padisë ia ka dërguar të paditurës, e cila në bazë të fletë kthesës së Postës së Kosovës konstatohet se e ka pranuar me datën 05.03.2024, mirëpo brenda afatit të caktuar tre ditor nuk ka vepruar sipas udhëzimeve si në aktvendim.

Andaj në bazë të nenit 99 lidhur me nenin 102 par.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, konsiderohet që paditësi e ka tërhequr padinë në këtë çështje juridike, sikurse u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr 260/19 data 31.10.2024

Gjyqtari

Përparim Zeka

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme sipas ligjit.